

Thirrje për aplikim

Në kuadër të projektit “**Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës**” AIS 10950 (me kohëzgjatje 3 vjeçare), hapet sot, e mërkure me datë 19 prill 2018, procedura për përzgjedhjen e:

15 ekspertëve të fushës sociale (psikolog, punonjës social, edukator/mësues) - Shkodër

Objekti i thirrjes është përzgjedhja, krijimi dhe përgatitja e një ekipi trajnuesish që do punojnë në territor për azhurnimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të operatorëve social aktiv në shërbimet sociale të Shkodrës.

Personat e përzgjedhur do marrin pjesë në një seri trajnimesh që do mbahen në Shkodër në muajt maj-qershor 2018, ku gjithsej do zhvillohen 4 cikle trajnimi gjatë fundjavave (nga e premte pasdite deri të diele paradite).

Trajnimet do zhvillohen nga pedagog të Departamentit të Shkencave të Edukimit “Giovanni Maria Bertin” (EDU) të Universitetit të Bolonjës në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë dhe Punëve Sociale të Universitetit të Shkodrës.

KRITERET E KËRKUARA PËR PRANIMIN NË PËRZGJEDHJE

Profili: thirrja është e hapur për 3 kategori profesionesh (psikolog, punonjës social, edukator/mësues) që punojnë në shërbime publike ose private (shërbime sociale shtetërore, Bashkia, OJF, etj.)

Për pranimin në përzgjedhje kërkohen kriteret e mëposhtme:

- a) Formimi: kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë 3 vjeçar (Bachelor) dhe diplomë të ciklit të dytë (Master), ose këto ekuivalente me diplomë të studimeve universitare me 4 vite akademike. Të paktën njëra nga diplomat duhet të jetë në fushën e psikologjisë, edukimit ose të punës sociale. Prania e më shumë diplomave kualifikuese të njohura (Master, kurse specializimi, etj.) do vlerësohen më një pikëzim më të lartë.
- b) Eksperiencë profesionale: do vlerësohen eksperiencat e punës të lidhura me profilin profesional të thirrjes për aplikime (psikolog, punonjës social, edukator/mësues), duke iu referuar veçanërisht shërbimeve asistenciale dhe edukative që ju drejtohen jetimëve, të miturve, personave me aftësi të kufizuar, pakicave, dhe personave në situatë të disavantazhit kulturor / social / ekonomik.

- c) Esperienca didaktike: do vlerësohen eksperiencat në fushën e mësimdhënies (në gjimnaz, Universitet, etj.), në formimin profesional, në organizimin e seminareve trajnuese dhe ndërgjegjësuese.
- d) Njohja e gjuhëve të huaja: preferohet njohja e gjuhës italiane.
- e) Mosha: mbi 25 vjeç.

Kandidatët duhet të nisin CV-të e tyre brenda **orës 13:00** me datë **27 prill 2018** në adresën e postës elektronike **albania@ipsia-acli.it** ose mund ta dorëzoni fizikisht pranë Qendrës Rinore Arka, Rruga Palokë Kurti, 1, 4001 Shkodër. Kandidatët që kanë kaluar vlerësimin e parë, të cilët kanë përmbushur kriteret e pranimit, do kontaktohen për një intervistë me përfaqësues të partnerëve të projektit.

Për të aplikuar në trajnim, kandidatët do vlerësohen në bazë të:

- **Curriculum Vitae (CV)**
- **Intervistës**

Përzgjedhja do bëhet duke vlerësuar secilin kandidat me një pikëzim nga 1 në 5 për secilin kriter të lartpërmendur. Mbi bazën e pikëzimit që do ketë secili kandidat, do përzgjidhen 15 persona me pikët më të larta, të cilët do kontaktohen nëpërmjet postës elektronike.

Shënim: **intervista** do ketë rol kryesor në përzgjedhjen e kandidatëve.

CERTIFIKATË PJESËMARRËSE

Për tu pajisur me certifikatë të akredituar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duhet të frekuentohen të paktën 90% të orëve të leksioneve. Pjesëmarrja nuk është kusht i vetëm për tu pajisur me certifikatë. Pjesëmarrësit e trajnimit, duhet të jenë aktiv brenda punëve në grup. Dhe në fund të trajnimit, pjesëmarrësit do përpunojnë 4 module trajnuese.

Gjatë kursit, pjesëmarrësit do vlerësohen në bazë të: pjesëmarrjes aktive në leksione, detyrave individuale, përpunimit të moduleve trajnuese. Ky përpunim ka për qëllim krijimin e 4-tër moduleve trajnimi (1 për psikolog, 1 për edukator, 1 për punonjës social, 1 për kujdestarë).